



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1437 Prot.

Tiranë, më datë 28.12.2022

VENDIM

Nr. 559, datë 28.12.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.12.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor- shkencor “Bylis 2022, në kuadër të shkollës doktorale”, me drejtues shkencor Prof. Dr. Luan Përzhitë, me aplikues dhe zhvillues Akademia e Studimeve Albanologjike;
2. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së.
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Eugen KALLFANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

